

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6265
E martë, 16 mars 2021
çmimi 0.40 €

Më 22 mars caktohet seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës

FAQE 7



MBROJTJA E ISH-PRESIDENTIT TË KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA DORËZUAR DISA MOCIONE TË PARAKOHSHME, KU NË NJËRËN PREJ TYRE KËRKOHET HEQJA E AKTAKUZËS NDAJ THAÇIT PËR, SIÇ THUHET, "MUNGESË TË JURIDIKSIONIT" ■FAQE 5

MBROJTJA E THAÇIT THOTË SE SPECIALJA S'KA JURIDIKSION PËR GJYKIMIN E TIJ

Mbrojtja e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka dorëzuar në Dhomat e Specializuara dhe në Zyrën e Prokurorit të Specializuar në Hagë disa mocione të parakohshme. Në një të tjetër prej tyre kërkohet heqja e aktakuzës ndaj Thaçit për, siç thuhet, "mungesë të juridiksionit". Sipas mbrojtjes, akuzat e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Hashim Thaçit e tejkalojnë juridiksionin e Dhomave të Specializuara pasi që "asnjë nga akuzat nuk kanë të bëjnë me pretendimet e raportit të Këshillit të Evropës, të përpiluar nga senatori Dick Marty, për 'trajtim johuman të njerëzve dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë'"



PDK-ja DHE AAK-ja NUK KANË VOTË PËR VJOSA OSMANIN PRESIDENTE



Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ua ka bërë të qartë Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit, se vota e kësaj partie për president varet nga qëndrimi i tyre për dhjetë temat që ua ka prezantuar në takimin e së hënës. Para se të vendosë PDK-ja për këtë çështje, Hoxhaj ka thënë se Kurti duhet të

tregojë nëse ka hequr dorë nga dhuna si mjet politik, si dhe duhet t'i sqarojë qëndrimet për dialogun me Serbinë, për marrëveshjen e Uashingtonit dhe për Minishengenin. Në takimin e dytë konsultativ, edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se është përgjegjësi e Kurtit dhe Osmanit t'i bëjnë votat për presidentin ■FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

PASQYRIMI I DEMONSTRATAVE TË '81-SHIT NË MEDIAT E SHQIPËRISË F. 10

Shkruan:
Bedri ISLAMI



AKTUALE



SHOIPTARËT E LUGINËS, NË HALL ME PASIVIZIMIN E ADRESAVE F. 3

13 TË VDEKUR NGA COVIDI BRENDA 24 ORËVE NË KOSOVË F. 3

PRISHTINA, GRAÇANICA DHE OBILIQI KOORDINOHEN PËR PROJEKTET E PËRBASHKËTA NDËRKOMUNALE F. 6

EKONOMI

NË 2020-n ANKESAT E KONSUMATORËVE U RRI TËN 100 PËR QIND F. 9

QEVERIA NDAN MJETE FINANCIARE PËR SHKK-në, DOGANËN, ATK-NË DHE AUV-në F. 9

SPORT

JUPA: SYNOJMË KUALIFIKIMIN HISTORIK F. 12

Bien shitjet e armëve në botë

NJU-JORK, 15 MARS - Dërgesat ndërkombëtare të armëve kanë qenë më të sheshta në periudhën 2016-2020, në krahasim me periudhën paraprake pesëvjeçare, mirëpo sërish janë afër nivelit më të lartë prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ka thënë Instituti Ndërkombëtar i Paqes (SIPRI), në raportin e publikuar më 15 mars.

Tri nga eksportueset më të mëdha të armëve, Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Gjermania, kanë rritur sasinë e dërgesave gjatë periudhës 2016-20, mirëpo rënia e eksporteve nga Kina dhe Rusia kompensojnë rritjen, ka thënë instituti me

bazë në Stokholm. Kjo ka qenë hera e parë prej periudhës 2001-2005, që shkalla e dërgesave të armëve mes shteteve nuk është rritur në krahasim me periudhën paraprake.

Shtetet e Bashkuara përbëjnë eksportueset më të mëdha, përkatësisht 37 për qind të shitjeve të armëve globale gjatë periudhës së fundit, ka thënë SIPRI.

Gjysma e armëve amerikane janë dërguar në Lindje të Mesme.

Rusia, eksportuesja e dytë më e madhe në botë, është përgjegjëse për një të pestën e shitjes së armëve, ndonëse

shitjet i kanë rënë për 22 për qind në krahasim me periudhën 2011-2015, kryesisht për shkak të rënies së importit nga India.

Hulumtuesi i lartë në SIPRI Pieter Wezeman ka thënë se ende është shumë herët të shihet nëse rënia e transferit të armëve do të vazhdojë. "Ndikimi ekonomik i pandemisë mund të ndikojë me rivlerësim të importeve të armëve në disa shtete në të ardhmen", ka thënë Wezeman, duke theksuar se në të njëjtën kohë, edhe pse në periudhë të pandemisë më 2020, shumë shtete kanë nënshkruar kontrata të mëdha për armë.



Për shembull, Emiratet e Bashkuara Arabe kanë nënshkruar së fundmi një marrëveshje me Shtetet e Bashkuara për blerje të 50 aeroplanëve F-35 dhe të mbi 18

dronëve, në kuadër të një pakete prej 23 miliardë dollarëve.

Shtetet e Lindjes së Mesme është thënë se kanë regjistruar rritjen më të madhe në import të armëve, me 25 për qind rritje.

"AstraZeneca" thotë se nuk ka prova që vakcina e saj shkakton mpiksje gjaku



LONDËR, 15 MARS - Kompania "AstraZeneca" ka njoftuar se nga analiza e të dhënave nuk ka gjetur prova se vakcina e saj kundër koronavirusit shkakton mpiksje gjaku. Këto përfundime dolën derisa Irlanda dhe Holanda iu bashkuan një liste në rritje vendesh që po pezullojnë përdorimin e kësaj vakcine.

"Një rishikim i kujdesshëm i të gjitha të dhënave të sigurisë nuk ka nxjerrë prova të një rreziku në rritje të embolizmit pulmonar, trombozës së thellë të venave ose trombocitopenisë, në asnjë grupmoshë, gjini, grupim apo vend të veçantë", ka njoftuar kompania "AstraZeneca". Edhe Austria ndaloi së përdoruri

vakcinën javën e kaluar ndërsa po heton një vdekje të shkaktuar nga mpiksja e gjakut.

Përveç vetë kompanisë, Agjencia Evropiane e Barnave dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë kanë thënë se nuk ka asnjë tregues që rastet e mpiksjes ishin të lidhura me vakcinën.

Bie përkrahja për partinë e Merkelit në zgjedhjet rajonale

BERLIN, 15 MARS - Partia e kancelares gjermane Angela Merkel, Unioni Demokristian (CDU), ka shënuar humbje më 14 mars në dy shtete kyçe në zgjedhjet rajonale. Ky rezultat pritet ta përcaktojë rrugën politike për pasardhësin e Merkelit, që do të zgjidhet më vonë gjatë këtij viti.

Mbështetja ndaj CDU-së ka rënë në 24.1 për qind në landin Baden-Wuerttemberg dhe në 27.7 për qind në vendin fqinj Rheinland-Palatinate, sipas të dhënave preliminare. Rezultatet kanë qenë më të

dobëta ndonjëherë për CDU-në në këto dy shtete, mirëpo zyrtarë partiakë kanë thënë se rezultatet mund të ndryshojnë për shkak të dërgimit të shumë votave me postë. "Kjo nuk është natë e mirë e zgjedhjeve për CDU-në", ka thënë sekretari i përgjithshëm i partisë, Paul Ziemiak, duke thënë se këto vota reflektojnë pakënaqësi në rritje, moskuptim dhe mungesën e durimit ndaj qeverisë për menaxhim të pandemisë së koronavirusit.

Partia Demokristiane dhe

partia e saj simotër Unioni Socialkristian CSU janë dëmtuar edhe nga supozimet se dy ligjvënës kanë përfituar nga marrëveshjet e hershme për blerje të maskave në pandemi.

Zgjedhjet në Gjermani janë mbajtur në një periudhë të rritjes së shkallës së infektimit me koronavirus.

Në këto zgjedhje popullariteti ndaj Partisë së Gjelbër është rritur, teksa shtohen shqetësimet për ndryshime klimatike, andaj kjo parti mund të ketë ndikim të madh



në zgjedhjet kombëtare që pritet të mbahen në shtator. Në të dyja këto shtete, partia e ekstremit të djathtë Alternativa për Gjermaninë ka pasur rezultat më të dobët se

më 2016, mirëpo sërish ka siguruar 10 për qind të votave. Të gjitha partitë e tjera kanë refuzuar të bashkëpunojnë me këtë parti në një koalicion qeveritar.

E diela e përgjakshme në Myanmar



NAYPYITAW, 15 MARS - Një gjykatë në Myanmar ka shtyrë një seancë virtuale për lideren e shkarkuar Aung San Suu Kyi për shkak të problemeve me internetin, ndërkohë që vazhdon shtypja e protestave kundër puçit ushtarak të 1 shkurtit. Të paktën 38 protestues janë vrarë më 14 mars, pasi forcat

e sigurisë kanë shtypur protestuesit kundër puçit, duke kërkuar lirimin e Suu Kyisë dhe rikthimin e demokracisë në këtë shtet të Azisë Juglindore. Forcat e sigurisë kanë gjuajtur me armë zjarri protestuesit pro-demokracisë, duke vrarë 22 prej tyre në Hlaingtharyar, ka thënë grupi vëzhgues

Asociacioni për Ndihmë për të Burgosurit Politikë.

Në raportime të tjera është thënë se numri i personave të vrarë në qytetin Yangon ka shkuar në 63. Prej puçit të 1 shkurtit, protestuesit kanë dalë në rrugët e Myanmarit, pavarësisht rritjes së shkallës së dhunës nga ushtria.

13 të vdekur nga Covidi brenda 24 orëve në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 MARS - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 3 570 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 574 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 13 raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Vushtrri tri raste (75, 79, 89 vjeç), Gjilan dy raste (75, 78 vjeç), Kamenicë dy raste (76, 73 vjeç), Prizren dy raste (59, 74 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (53 vjeç), Istog një rast (45 vjeç), Prishtinë një rast (74 vjeç) dhe Skenderaj një rast (67 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 77 827 raste nga 358 537 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 715 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 394 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 65 060 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 058.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 233 raste, Gjakovë 36 raste, Fushë-Kosovë 33 raste, Pejë 31 raste, Gjilan 27 raste, Kamenicë 24 raste, Mitrovicë 24 raste, Vushtrri 24 raste, Podujevë 21 raste, Ferizaj 20 raste, Lipjan 18 raste, Obiliq 18 raste, Klinë 11 raste, Drenas 6 raste, Viti 6 raste, Prizren 5 raste, Rahovec 5 raste, Deçan 4 raste, Dragash 4 raste, Shtime 4 raste, Suharekë 4 raste, Istog 3 raste, Kaçanik 3 raste, Malishevë 3 raste, Novobërdë 3 raste, Skenderaj 3 raste dhe Shtërpçë 1 rast.



Shqiptarët e Luginës, në hall me pasivizimin e adresave

PRISHTINË, 15 MARS - Vitin e kaluar Teuta Fazliu u njoftua nga autoritetet komunale të Bujanocit se emri i saj është hequr nga lista e vendqëndrimit ku kishte qenë e regjistruar. Fazliu ka treguar për "Radion Evropa e Lirë" se me pasivizimin e adresës së saj dhe shumë banorëve të tjerë të komunave jugore të Serbisë, Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc, Beogradi zyrtar po bën shkelje të të drejtave të njeriut. "Kanë filluar që vendqëndrimet t'i pasivizojnë, do të thotë t'i fshijnë emrat e njerëzve nga vendqëndrimet. Unë jam një nga viktimat e radhës në këtë çështje. Në momentin që ta pasivizojnë atë adresë, më nuk ke të drejtë të aplikosh për dokumente. Do të thotë, derisa ke afat në dokumente, mund t'i shfrytëzosh ato, siç është pasaporta, letërnjoftimi, patentëshoferi, librezha shëndetësore", ka thënë Fazliu. Ajo ka pohuar se pasi një person, të cilit i është pasivizuar adresa, paraqitet që të marrë dokumente të reja, autoritetet i thonë se nuk mund të aplikojë për dokumente të reja pasi nuk ka vendqëndrim.

Teuta Fazliu, e cila vitet e fundit jeton në Kosovë, thotë se ka shumë raste kur shqiptarët, që janë nga këto komuna në jug të Serbisë, nuk janë njoftuar fare se janë hequr nga lista e vendbanimeve. Ajo ka deponuar ankesa në instanca të ndryshme, përfshirë edhe në Gjykatën Administrative dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. "Unë e kam bërë edhe një ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme sepse policia i raporton ministrisë. Ata pas dy muajve më kanë kthyer përgjigje negative, duke thënë se



unë nuk kam të drejtë ankese dhe e kanë shkruar në deklaratë se unë nuk jetoj këtu, jetoj dhe punoj në Prishtinë dhe jam e martuar me kosovar. Do të thotë, një paragraf shumë i paarsyeshëm", ka thënë Teuta Fazliu.

Përfaqësuesit politikë të shqiptarëve në komunat në jug të Serbisë, në Preshevë, Medvegje e Bujanoc, që njihen edhe si Lugina e Preshevës, thonë se vitet e fundit është rritur dukuria e pasivizimit të adresave të shqiptarëve. Sipas tyre, pasivizimi i adresave po e ndryshon strukturën etnike të këtyre komunave.

Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi, Ragmi Mustafi, ka theksuar për REL se po ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura që të ndalet pasivizimi i

adresave. "Këto vendime janë antikushetuese dhe anticivilizuese. Ne e kemi konsideruar se ky proces është sa masiv po aq edhe selektiv ndaj shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe më së miri e dëshmon gjendja në Komunën e Medvegjës", ka deklaruar Mustafi.

Megjithatë, sipas vlerësimeve të Këshillit Kombëtar Shqiptar, Mustafi thotë se janë mbi 3 000 adresa që janë pasivizuar në Medvegje dhe mbi 2 000 në Preshevë e Bujanoc.

Përfaqësuesit e shqiptarëve në Serbi kanë shprehur shqetësimin që shqiptarët që janë larguar nga Lugina e Preshevës drejt Kosovës që nga viti 1999, nuk e kanë të rregulluar statusin civil as në Kosovë.

Prej vitit 2018 deri në fund të vitit

2020, 816 persona nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë fituar të drejtën e shtetësisë së Kosovës. Sipas Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, numri më i madh i personave që kanë kërkuar shtetësi të Kosovës, janë ata nga Serbia. "Numri më i madh i personave që fitojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës iu përkasin grupmoshave 18-34 dhe 35-64. Kërkesat për fitim të shtetësisë janë nga personat me shtetësi serbe, shqiptare, maqedonase etj", thuhet në një përgjigje me shkrim nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës.

Numri më i madh i atyre që u bënë shtetas të Kosovës ishte në vitin 2018, përkatësisht 349 persona.

Në Ministrinë e Punëve të

Brendshme të Kosovës thanë se nuk e dinë arsyen e kërkesave për ta pasur shtetësinë e Kosovës por, siç thanë, "të gjithë ata që i plotësojnë kriteret sipas Ligjit për Shtetësi, përfitojnë shtetësinë e Kosovës".

Kërkesa për fitimin e shtetësisë së Kosovës me natyralizim parashtrohet nga personi i huaj i moshës madhore personalisht në Zyrën e Gjendjes Civile sipas vendbanimit të parashtruesit të kërkesës në Republikën e Kosovës.

Kërkesës duhet bashkangjitur dëshmitë si: certifikata e lindjes dhe martesës për personat e martuar, dëshmia e lejes së përhershme të qëndrimit për pesë vjet, dëshmia që i ka përmbushur të gjitha detyrimet financiare dhe dokumente të tjera.



FITUESI I ZGJEDHJEVE TË 14 SHKURTIT KA NISUR TAKIMET KONSULTATIVE ME SUBJEKTET E TJERA POLITIKE PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË RI

PDK-ja dhe AAK-ja nuk kanë votë për Vjosa Osmanin presidente

Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ua ka bërë të qartë Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit, se vota e kësaj partie për president varet nga qëndrimi i tyre për dhjetë temat që ua ka prezantuar në takim e së hënës. Para se të vendosë PDK-ja për këtë çështje, Hoxhaj ka thënë se Kurti duhet të tregojë nëse ka hequr dorë nga dhuna si mjet politik, sikurse duhet t'i sqarojë qëndrimet e tij për dialogun me Serbinë, marrëveshjen e Uashingtonit dhe Minishengenin. Në takimin e dytë konsultativ, edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se është përgjegjësi e Kurtit dhe Osmanit t'i bëjnë votat për presidentin

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINE, 15 MARS - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, kanë filluar konsultimet me partitë politike për krijimin e institucioneve të reja. Përfaqësuesit e PDK-së dhe të AAK-së kanë bërë me dije se në këto rrethana nuk kanë votë për presidentin e ri.

Në takimin e parë të këtij lloji, kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ua ka bërë të qartë atyre se nga çfarë varet vota e kësaj parti për presidentin e ri të

vendit. Pas takimit, Hoxhaj ka thënë se para se kjo parti të marrë një qëndrim përfundimtar për zgjedhjen e presidentit në organet e saj, Albin Kurti dhe Vjosa Osmani duhet të japin shpjegime për dhjetë tema. "1. Sa herë që ka pasur zgjedhje të qeverisë ose të presidentit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, institucionet janë sulmuar dhe dhuna është ushtruar ndaj shumicës në Kuvend, në seancë duke hedhur gaz ose duke u sulmuar institucioni i Kuvendit. Unë kam kërkuar ta di nëse z. Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje do të heqin dorë nga dhuna politike si mjet politik.

2. Kam kërkuar të di qëndrimin e tyre për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë me qëllimin përfundimtar të njohjes reciproke. A do ta mbajnë ata premtimin e dhënë për qytetarët e Kosovës se nuk do të fillojnë dialog me Serbinë pa një kërkimfalje zyrtare nga Serbia dhe kthimin e të gjithë personave të zhdukur?", ka thënë Hoxhaj. Së treti, ai ka kërkuar të dijë qëndrimin e tyre në lidhje me Asociacionin e Komunave Serbe. "4. Ata i kam pyetur edhe lidhur me pozicionimin e tyre në lidhje me demarkimin e kufirit me Malin e Zi? Dhe nëse ata, në



përputhje me shkëmbimin e letrave midis presidentëve të Kosovës dhe të Malit të Zi, a do ta rishikojnë kufirin, posaçërisht për pjesën e Zhlebit dhe të Çakorrit, ashtu siç kishin premtuar. Ata duhet të dalin edhe me një afat kohor për jetësimin e këtij premtimi. 5. Nuk mora përgjigje, po ashtu, nëse ata do ta respektojnë dhe do ta zbatojnë Marrëveshjen e Uashingtonit?", është shprehur Hoxhaj, duke shtuar se i ka pyetur Kurtin dhe Osmanin edhe nëse do të pranojnë të hyjnë në Tregun e Përbashkët Rajonal (Minishengen) pa njohjen e plotë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. "7. Gjatë qeverive Kurti 1 dhe Hoti, sovraniteti i Republikës së Kosovës u pezullua kur këto qeveri u tërhoqën nga kërkimi i anëtarësimeve në organizata ndërkombëtare dhe njohje të Republikës së Kosovës. Kërkova të di nëse Kosova do të aplikojë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe se a do të kërkojnë njohje nga të gjitha vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara duke i dhënë fund pezullimit të sovranitetit? 8. Trashëgimia juaj politike që nga viti 2007 ka qenë ta kundërshtoni Planin Ahtisaari, i cili është në thelb karakteri kushtetues i Kosovës. Kam kërkuar të di nga z. Kurti nëse ka hequr dorë nga ky qëllim?", ka thënë Hoxhaj. Në këtë takim, ai ka kërkuar sqarime edhe për reciprocitetin me Serbinë dhe çështjen e fusnotës, e cila është kritikuar fuqishëm nga Kurti dhe Osmani. "9. Një premtim ka qenë edhe reciprociteti. Kam kërkuar të di nga ta nëse do të rikthehet reciprociteti me Serbinë dhe a do të jetë ashtu si gjatë qeverisë Kurti 1 reciprocitet administrativ apo do të zbatohet reciprociteti i plotë politik, ekonomik dhe tregtar? 10. Z. Kurti dhe znj. Osmani kanë kundërshtuar marrëveshjen e Brukselit në lidhje me fusnotën? Kam kërkuar një zotim nga ta nëse do ta anulojnë këtë marrëveshje dhe a do të tërhiqen nga fusnota, siç kanë premtuar gjatë gjithë viteve", ka thënë Hoxhaj. Ai ka treguar se kur të marrim një përgjigje për këto çështje që, sipas tij, janë thelbësore për të ardhmen e Republikës së Kosovës, PDK-ja do të marrë një qëndrim në organet e saj partiake në lidhje me pozicionin që do të ketë për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës. Pas Hoxhajt, Kurti dhe Osmani kanë pritur në takim liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj. Ky i fundit ka thënë se është përgjegjësi e Lëvizjes Vetëvendosje që t'i sigurojë votat e nevojshme në kuvendin e ri për zgjedhjen e presidentit të Kosovës. "Fituesit e zgjedhjeve e gjejnë formulën për ta krijuar qeverinë. Dy të tretat për

presidentin janë në përgjegjësinë e tyre", ka deklaruar Haradinaj pas takimit me Kurtin dhe Osmanin. Ai ka treguar se në këtë mandat partia e tij do të jetë opozitë. "Aleanca është opozitë në ardhje, sepse në krijimin e institucioneve do të jemi opozitë. Ramë dakord që në sfidat që i ka Kosova, në këto funksione, Aleanca do të bashkëpunojë për tema të interesit nacional, duke e ruajtur vendin, por duke qenë këtu për ta bërë funksionale demokracinë e vendit. Synohet një koncentrim i pushteteve. Mendojmë se funksioni ynë është i rëndësishëm në kohën që vjen", ka thënë Haradinaj. Në zgjedhjet e 14 shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 50.28 për qind të votave apo 58 ulëse në Kuvend, Partia Demokratike e Kosovës ka fituar 17 për qind apo 19 deputetë, Lidhja Demokratike e Kosovës ka marrë 12.73 për qind apo 15 deputetë dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka marrë 7.12 për qind apo 8 deputetë.

Abdixhiku i gatshëm të takohet të premten me Kurtin dhe Osmanin

Kryetari i ri i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se do të jenë konstruktiv sa i përket zgjedhjes së presidentit të ri. Ai ka bërë me dije se është duke pritur konfirmimin për takimin e së premtes nga Kurti dhe Osmani. "Po presim për konfirmimin e takimit të së premtes, ditën e propozuar nga ne. Do të jemi konstruktivë në frymën themeltare të LDK-së, përfshirë edhe atë të Rugovës dhe secilit veprimtar të LDK që kontribuon për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e institucioneve të Kosovës dhe jo në rrënimin e tyre", ka thënë ai, pas homazheve që ka bërë te varri i ish-liderit të këtij subjekti politik, Ibrahim Rugova. Kurti dhe Osmanin kishin paraparë që të hënë në realizimin një takim me udhëheqësit e LDK-së, por kryetari i sapozgjedhur i kësaj partie, Lumir Abdixhiku, ka thënë se nuk mund t'i përgjigjet ftesës së këtij takimi ngaqë fillimisht duhet të konsultohet me organet e partisë.

Mbrojtja e Thaçit thotë se Specialja s'ka juridiksion për gjykimin e tij

Mbrojtja e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka dorëzuar disa mocione të parakohshme, ku në njërin prej tyre kërkohet heqja e aktakuzës ndaj Thaçit për, siç thuhet, "mungesë të juridiksionit"



Prishtinë, 15 mars (ER) - Mbrojtja e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka dorëzuar në Dhomat e Specializuara dhe në Zyrën e Prokurorit të Specializuar në Hagë, disa mocione të parakohshme, ku në njërin prej tyre kërkohet heqja e aktakuzës ndaj Thaçit për, siç thuhet, "mungesë të juridiksionit". Sipas mbrojtjes, akuzat e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Hashim Thaçit e tejkalojnë juridiksionin e Dhomave të Specializuara pasi "asnjë nga akuzat nuk kanë të bëjnë me pretendimet e raportit të Këshillit të Evropës, të përpiluar nga senatori Dick Marty, për 'trajtim johuman të njerëzve dhe trafikim të paligjshëm me organet njerëzore në Kosovë'". Mbrojtja e Thaçit mbështetet në argumentet se Dhomat e Specializuara janë themeluar për ta zbardhur të vërtetën për akuzat e Dick Martyt. "Debatet në Kuvendin e Kosovës për ndryshimet kushtetuese konfirmojnë se qëllimi ishte që të kufizohej juridiksioni i Dhomave të Specializuara, vetëm për pretendimet e raportit të Dick Martyt dhe që ky institucion të kishte mandat pesëvjeçar. Referenca për raportin e Dick Martyt në Kushtetutë nuk është thjesht 'mbiemër', por është qenësore për juridiksionin e saj", thuhet në mocion.

Ndërkaq, në mocionin tjetër, që është deponuar, mbrojtja argumenton se Thaçi i janë shkelur të drejtat për një dëgjim të drejtë dhe të paanshëm publik si dhe

për një gjykim të drejtë, brenda një kohe të arsyeshme. Andaj, ata kërkojnë nga gjyqtari i procedurës paraprake që ta lirojë Thaçin dhe t'i hedhë poshtë akuzat ndaj tij.

Kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreut të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi dhe ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, është konfirmuar aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ata gjenden në paraburgim në Hagë dhe janë deklaruar të pafajshëm. Sipas aktakuzës, Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi dyshohen për veprat penale që kanë të bëjnë me krime lufte: ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit: burgosje, akte të tjera çnjerëzore, zhdukje me forcë të personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999. Krime pretendohet se janë kryer në disa lokacione të Kosovës dhe në veri të Shqipërisë, përkatësisht në Kukës dhe Cahan.

Pretendimet e palës mbrojtëse

Në këtë mocion pala mbrojtëse pretendon se Dhomat e Specializuara kanë ngritur aktakuzë pas përfundimit të afatit të përkohshëm pesëvjeçar

që, sipas tyre, ka përfunduar në gusht të vitit 2020. "Mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, në thelb ishte i thjeshtë. (Ish-kryeprokurorja e Tribunalit në Hagë, Carla) Del Ponte kishte folur për trafik organesh, të cilat u konfirmuan me entuziazëm nga raportit i Martyt. Ky raport ishte shkas për hetimin e Task-Forcës speciale hetuese", thuhet në mocionin e palës mbrojtëse, e cila thotë se edhe vetë prokurori që hetoi pretendimet e Martyt, Clint Williamson, nuk kishte gjetur dëshmi të mjaftueshme për "trafikim organesh". "Përkundrazi, aktakuza nuk i referohet krimet të organizuar në Kosovë ose diku tjetër. Në këtë aktakuzë, Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk po ndjek penalisht krimet e pretenduara në raportin e Dick Martyt, por po ndjek një çështje tjetër, e cila, për arsyt e përcaktuara më sipër, nuk ka as juridiksion e as autoritet ta bëjë këtë", shtohet në mocion.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihen edhe si Gjykata Speciale, hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Këto krime të pretenduara përmenden në një raport të Këshillit të Evropës, të vitit 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty.

Gjilani ka aktualisht 360 raste aktive me Covid

GJILAN, 15 MARS (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilani ka mbajtur takimin për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit. Në takim u bë me dije se Gjilani aktualisht ka 360

raste aktive me Covid-19, ndërsa iu bë thirrje qytetarëve dhe bizneseve që japin shërbime, të vazhdojnë t'i respektojnë masat: mbajtjen e maskës dhe distancën fizike. Pasqyra e përgjithshme në Gjilani që prej fillimit të

pandemisë është si vijon: nga 14 773 mostra, 4 174 kanë rezultuar pozitivë, 3 699 janë shëruar, 115 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 360 raste janë aktive, të hospitalizuar me Covid janë 82 persona.



Respektimi i masave anti-Covid, Drejtorja e Inspektionit në Gjakovë nis aksionin

GJAKOVË, 15 MARS (ER) - Në kuadër të monitorimit të situatës së pandemisë në qytetin e Gjakovës dhe pas rritjes së rasteve me Covid-19 ditët e fundit, inspektorët sanitarë në Komunën e Gjakovës, në koordinim me inspektorët sanitarë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) dhe Policinë e Kosovës, kanë kryer inspektime në Komunën e Gjakovës.

Inspektorët gjatë aksionit kanë mbikëqyrur zbatimin e masave mbrojtëse si dhe respektimin e distancës fizike në lokalet e gastronomisë të cilat veprojnë në Gjakovë. Drejtori për Punë Inspektuese në Komunën e

Gjakovës, Fazli Hoxha, ka thënë se gjatë inspektimeve është parë se nëpër bizneset e Gjakovës janë duke u respektuar kënaqshëm masat anti-Covid. Për këtë, ai ka falënderuar pronarët e bizneseve dhe i ka inkurajuar që edhe më tutje t'i zbatojnë masat anti-Covid në fuqi. "Qëllimi i këtyre aksioneve është vetëdijesimi i qytetarëve për rrezikun nga pandemia dhe se respektimi i distancës dhe masat mbrojtëse pasi janë vitale për ruajtjen e shëndetit.

Andaj, inspektorët sanitarë edhe më tutje do t'i vazhdojnë inspektimet e tilla, sepse vetëm kështu mbrojmë shëndetin e qytetarëve tanë", ka thënë Hoxha.



Prishtina, Graçanica dhe Obiliqi koordinohen për projektet e përbashkëta ndërkomunale



PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Në hapësirat e Komunës së Prishtinës është mbajtur takimi me Komunën e Graçanicës dhe Obiliqit me temën "Diskutimi rreth projekteve potenciale të përbashkëta ndërkomunal". Në takim janë diskutuar temat të cilat paraqesin shqetësime të përbashkëta dhe kërkojnë zgjidhje me komunitet fëmijë të ndërlidhura si dhe për projektet e përbashkëta. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti,

ka thënë se me Komunën e Obiliqit janë diskutuar temat të cilat kërkojnë trajtim të përbashkët siç janë ndotja e ajrit, zona ekonomike, trajtimi i ujërave të zeza si dhe mundësia e bashkëpunimit ndërkomunal për çështjen e trafikut urban. Ndërsa me Komunën e Graçanicës janë diskutuar temat rreth korridorit ekonomik në drejtim të Shkupit, shkarkimi dhe trajtimi i ujërave të zeza, ka bërë me dije Ahmeti.

Mërgimtari Halil Haxhija i dhuron pajisje shërbimit të zjarrfikësve në Drenas

DRENAS, 15 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim mërgimtarin Halil Haxhija, i cili ka dhuruar pajisje të shërbimit të zjarrfikësve në Drenas dhe ka falënderuar për këtë

ndihmë që do t'i ndihmojë shërbimit të zjarrfikësve për kryerjen e detyrave në terren. Me këtë rast, kryetari Lladrovci ka dhënë mirënjohje në shenjë falënderimi për dhurimin e dy fiskajave profesionale në

Njësinë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në Drenas.

Mërgimtari Haxhija ditë më parë i ka dhuruar shefit të Zjarrfikësve, Afrim Gjeli, dy fiskaja profesionale, vlera e të cilave është rreth 2 000 euro.



Më 22 mars caktohet seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar për 22 mars seancën konstituive të legjislaturës së tetë të Kuvendit të Kosovës. "Kjo seancë do të mbahet në orën 10:00, teksa përgatitjet për mbajtjen e saj do të kryhen konform procedurave në fuqi", thuhet në njoftimin e lëshuar nga zyra e Osmanit.

Ky njoftim vjen pasi Osmani, së bashku me liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, takuan të hënën përfaqësues të



Partisë Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, për t'u konsultuar për krijimin e institucioneve të reja. Thirrja e seancës konstituive pason certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Në këto zgjedhje Lëvizja Vetëvendosje ka fituar mbi 50 për qind të votave, duke siguruar 58 ulëse në Kuvend. Partia Demokratike e Kosovës do t'i ketë 19 deputetë, Lidhja Demokratike e Kosovës 15, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës tetë.

Nga komunitetet, Lista Serbe i ka fituar të dhjetë ulëset e garantuara; dy ulëse i ka fituar Partia Demokratike Turke e Kosovës dhe nga një ulëse kanë fituar Koalicioni Vakut, Partia e Re Demokratike, Partia Gorane, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Partia e Ashkalinjve për Integrim, Iniciativa Rome, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës dhe Unioni Socialdemokrat.

Pas konstituimit të Kuvendit, i hapet rruga formimit të qeverisë së re, të cilën pritet ta udhëheqë Kurti.

Klinika e Onkologjisë ka kryer mijëra shërbime për një vit

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 MARS - Klinika e Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës vitin e kaluar ka ofruar mijëra shërbime mjekësore për pacientët e prekur me kancer, ndonëse sistemi shëndetësor në vend po sfidohej nga pandemia Covid-19 dhe ishte i detyruar të operonte me kapacitete të shkurtuara. Pavarësisht prej situatës së krijuar, në Onkologji janë kryer

të gjitha kontrollet e zakonshme dhe vizitat specialiste. "Me kohë, pa vonesë, pacientët kanë marrë edhe kemioterapitë, terapitë biologjike, terapitë e cakt, hormonoterapitë dhe imunoterapitë. Për më tepër, është ofruar mjekim për pacientët nga 24 deri në 48 ore, ndërkaq janë realizuar të gjitha seancat e mjekimit me rrezatim kurativ dhe paliativ, pa lënë anash mjekimin ambulator paliativ, vizitat psikologjike dhe vizitat e mjekimeve

fizioterapeutike", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së. Së fundmi, është kryer edhe rrezatimi i sofistikuar me Brahiterapi për tumoret e organeve gjenitale të femrës. "Shumë shpejt do të fillojë punën edhe aparati modern për rrezatim, i cili përdor teknikat IMRT, IGRT, dhe Combeam CT. Vlen të përmendet se asnjë pacient, që ka qenë në mjekim onkologjik dhe është infektuar me Covid-19, nuk ka përfunduar me fatalitet", është theksuar në njoftimin e QKUK-së.



Kryetari i ri i LDK-së bën homazhe te varri i ish-presidentit Rugova

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, së bashku me bashkëpunëtorë dhe anëtarë të strukturave të LDK-së, kanë bërë homazhe të hënën te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova. "Sot jemi këtu për ta nderuar kryetarin e parë të LDK-së dhe themelтарin e Republikës së Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, për të treguar se idetë tradicionale të LDK-së

për shtetin janë të përhershme dhe të njëjtat i kultivojmë edhe ne", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se e ardhmja ndërtohet duke respektuar të shkuarën. "E kaluara jonë është e kaluar me të cilën mburremi, por ajo s'duhet të na mjaftojë. E ardhmja ndërtohet duke respektuar të shkuarën, njëkohësisht duke u dhënë përgjigje çështjeve që janë emergjente për Republikën e Kosovës", ka thënë Abdixhiku.

Ines Demiri merr kartelën identifikuese prej diplomateje në Izrael

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - E ngarkuara me punë e Kosovës në Izrael, Ines Demiri, ka marrë kartelën diplomatike të këtij vendi. Kjo u bë me dije nga shefi i Protokollit i Ministrisë së Jashtme izraelite, Gil Haskel. Haskel i ka dorëzuar kartelën Demirit, duke i uruar asaj

mirëseardhje. "Isha i nderuar t'i dorëzohej Ines Demirit kartelën diplomatike të Izraelit, si shefe e parë e Misionit të Ambasadës së parë të Republikës së Kosovës në Jerusalem, Izrael. Mirë se vini Ines! Mirë se vini Kosovë!", ka shkruar ai në "Twitter". Të dielën edhe zyrtarisht është

hapur Ambasada e Kosovës e cila gjendet në Jerusalem. Hapja ka ardhur si rezultat i marrëveshjes së Uashingtonit, e cila u nënshkrua më 4 shtator, ku u bë edhe njohja reciproke mes dy vendeve. Muajin e kaluar Kosova dhe Izraeli vendosën edhe marrëdhënie diplomatike.





Në 2020-n ankesat e konsumatorëve u rritën 100 për qind

Udhëheqësi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në MTI, Nijazi Shala, ka thënë se kjo ministri është zotuar se do ta përmirësojë pozitën e konsumatorit përmes legjislacionit në fuqi. Ai ka treguar se në vitin 2020 ankesat e konsumatorëve u rritën 100 për qind

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 MARS - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Konsumatorit, ka organizuar të hënën tryezë diskutimi me temën "Mbrojtja e konsumatorit gjatë pandemisë". Në këtë tryezë u konstatua se mbrojtja e konsumatorëve në Kosovë mbetet sfiduese për faktin se po përballen me pasiguri në ushqim, mashtrim me zbritje dhe fryrje të çmimeve.

Veçanërisht këto shqetësime kanë qenë të theksuara në pandemi, ku është rritur çmimi i produkteve bazike dhe farmaceutike.

Dardan Abazi nga INDEP-ja ka thënë se respektimi i të drejtave të konsumatorëve në Kosovë mbetet për t'u dëshiruar. "Për fatin tonë të keq ende diskursi politikbërës dhe institucionet përkatëse kanë lënë mbrapa të drejtat e konsumatorit, veçanërisht në kohën e pandemisë. Çdo ditë po marrim ankesa sa iu përket të drejtave të konsumatorëve. Këto ankesa ndërlihen me

zbritjet, me blerjet online, me sigurinë e ushqimit dhe me çështjet e tjera", ka deklaruar Abazi.

Helen Leurent, përfaqësuese nga Customer International, e cila në këtë tryezë u inkuadrua me një lidhje nga Zvicra, ka ngritur çështjen e ndotjes së ambientit nga plastika. "Shqetësimet tona janë për ndotjen e ambientit nga plastika dhe për përdorimin e plastikës njëpërdorimeshe. 12 milionë tonë të plastikës çdo vit përfundojnë në oqean, kurse gjithsejtë janë 14 milionë metër kub qese plastike. Bizneset dhe

prodhuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojën e konsumatorëve", ka thënë Leurent.

Vetëm gjatë vitit 2020 ankesat e konsumatorëve në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë (MTI) janë rritur për 100 për qind, ku gjysma e tyre, prej 1 017 sosh, nuk janë trajtuar nga institucionet përkatëse.

Udhëheqësi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në MTI, Nijazi Shala, ka thënë se kjo ministri është zotuar se do ta përmirësojë pozitën e konsumatorit përmes legjislacionit në fuqi. "Numri i ankesave nga konsumatorët është ngritur për më shumë se 100 për qind. Numri i këtyre ankesave gjatë vitit 2020 është 1 017 sosh si për fryrje të çmimeve farmaceutike dhe atyre bazike, sidomos në pandemi", ka thënë ai.

Zëdhënësi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, Lamir

Thaçi, ka theksuar se në periudhën e fundit kanë qenë vigjilentë sa iu përket kontrolleve të produkteve ushqimore si dhe zbatimit të masave anti-Covid. "Gjatë gjithë kohës kemi pranuar edhe ankesa nga konsumatorët, të cilat janë trajtuar me kujdes. Nga konsumatorët kemi kërkuar të dërgojnë dëshmi, sepse ne përballemi me gjykatat", ka thënë Thaçi, i cili ka shtuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës operon me numër të kufizuar të inspektorëve brenda vendit. "Kjo paraqet sfidë për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës ashtu dhe për konsumatorët. Kemi numër të kufizuar të inspektorëve brenda territorit të Kosovës, marrë parasysh edhe situatën pandemike e cila është sfiduese", ka thënë Thaçi.

Ai u ka bërë thirrje konsumatorëve që ta raportojnë për çdo parregullsi që mund të hasin në produktet ushqimore.

Qeveria ndan mjete financiare për ShKK-në, Doganën, ATK-në dhe AUV-në

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën ka miratuar vendime dhe dokumente të tjera sipas përgjegjësisë të saj kushtetuese dhe ligjore.

Vendimi i parë që mori aprovimin e kabinetit qeveritar ishte ai për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e shtesës në pagë për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Doganën e Kosovës, ATK-në dhe AUV-në, për shkak të angazhimit të shtuar gjatë pandemisë Covid-19, si dhe plotësim ndryshimin e vendimeve të qeverisë që kanë të bëjnë me mjetet nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike.

Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe vendimin për ndarjen e mjeteve shtesë financiare për Ministrinë e Shëndetësisë, në vlerë prej 10 milionë eurosh, për blerjen e materialeve, aparatave mjekësore si dhe angazhimin e personelit shëndetësor dhe mbështetës, për menaxhimin e pandemisë Covid-19.

Qeveria e Kosovës në këtë mbledhje ka miratuar edhe vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 8 milionë eurosh për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit të cilat do të destinohen për subvencionimin e tarifës për Burime të Ripërtërishme të Energjisë.

Në mbledhjen e 69, kabineti qeveritar ka aprovuar edhe vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 500 mijë eurosh për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për kryerjen e obligimeve financiare të kësaj ministrie.

Qeveria në këtë mbledhje, po ashtu, ka miratuar vendimin për kompensimin financiar të njëhershëm për delegatët e legjislaturës të vitit 1990 të cilët kanë certifikuar mandatin e deputetit në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës të datës 4 dhjetor 1999, që kanë marrë pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës më 2 korrik 1990 dhe më 7 shtator 1990 si dhe kanë vazhduar të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit deri më 24 maj 1992.

Po ashtu, qeveria ka aprovuar



edhe kërkesën e Sindikatës së Punëtorëve të Lotarisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 40 000 eurosh për mbështetje financiare për punonjësit e saj. Miratimin e qeverisë e kanë marrë nismat për negociimin e Marrëveshjes së Kredisë midis

Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Investime, për financimin e projektit "Reagimi i Kosovës ndaj pandemisë Covid-19 për NVM-të", si dhe për negociimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës

së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkimi Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian, për projektin "Mbështetja e BE-së për disponueshmërinë dhe qasjen në vaksinat kundër Covid-19 në Kosovë".

Sektori i industrisë nxjerrëse shënon rritje



PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat afatshkurtra të industrisë duke paraqitur indeksin e vëllimit industrial për TM4 2020 (2017=100). "Kjo anketë, me të dhënat që ofron, synon ta paraqesë ecurinë në industri: B - Nxjerrëse, C - Përpunuese, D - Furnizim me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, dhe E - Furnizim me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave, në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit në

industri", është thënë në njoftimin e ASK-së. Sipas ASK-së, në tremujorin e katërt (TM4) 2020, krahasuar me tremujorin e tretë (TM3) 2020, ka pasur rritje në: sektorin e industrisë nxjerrëse (B) me 98.71 për qind; sektorin e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) me 31.54 për qind; si dhe në sektorin e furnizimit me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) për 21.76 për qind.

Ndërsa ulje kishte në sektorin e industrisë përpunuese (C) për -

13.16 për qind.

"Ndërkaq, krahasuar TM4 2020 me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak TM4 2019, ka pasur rritje në: sektorin e industrisë nxjerrëse (B) 7.50 për qind; sektorin e furnizimit me rrymë, avull dhe ajër të kondicionuar (D) 3.69 për qind; dhe në sektorin e industrisë përpunuese (C) për 2.77 për qind. Ndërsa, ulje kishte në sektorin e furnizimit me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) për -13.71 për qind", është thënë në njoftimin e ASK-së.

Nitaj kërkon që të ndalen zgjedhjet e kryeshefave të ndërmarrjeve publike

Prishtinë, 15 shkurt (ER) - Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit, Muharrem Nitaj, me anë të një deklarate për media, ka bërë thirrje të ndalet procesi i zgjedhjes së bordeve në ndërmarrjet publike. Nitaj ka thënë se kjo çështje i përket qeverisë së re. Ai ka thënë se nuk e ka proceduar as zgjedhjen e bordit të Telekomit. "Shumicës së bordeve të ndërmarrjeve publike u ka kaluar mandati, por unë si ministër i

Ekonomisë dhe Ambientit kam vendosur të mos procedoj rizgjedhjen e tyre, duke e konsideruar të arsyeshme që ky proces t'i mbetet qeverisë së re. Unë nuk kam proceduar zgjedhjen e bordeve të reja, edhe në rastet kur kanë përfunduar të gjitha procedurat e rekrutimit, intervistimit dhe poentimit, siç është rasti me bordin e Telekomit", ka thënë Nitaj.

Ai ka treguar se u ka sugjeruar bordeve të përkohshme që të



mos shpallin konkurse për zgjedhjen e kryeshefave ekzekutivë. Ai ka treguar se ka kërkuar takim urgjent me Bordin e Infrakosit. "Unë si ministër u kam kërkuar që procesin ta rikthejnë në pikën zero por, pavarësisht kësaj, ata kanë proceduar tutje, duke mos përfillur kërkesat e ministrisë që është aksionare e kësaj ndërmarrjeje. Për më tepër, ky bord e ka zgjedhur kryeshefin ekzekutiv të Infrakosit për një mandat pesëvjeçar, ndërkohë që

me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, në nenin 15.1, përcaktohet që secili drejtor zgjedhet në mandat prej tre vjetësh. Kam kërkuar takim urgjent me bordin e Infrakosit për ta marrë shpjegimin e tij, gjë që nuk është realizuar me arsyetimin se kryetari i bordit nuk ndodhet në Kosovë", ka deklaruar Nitaj. Ai ka thënë se ka kërkuar interpretim ligjor edhe me rastin e zgjedhjes së kryeshefit të Postës dhe se është në pritje të këtij interpretimi.

Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (7)

Pasqyrimi i demonstratave të '81-shit në mediat e Shqipërisë



Shkruan: Bedri ISLAMI

Në vitin 1966, pas thuasje 18 vjet mbylljeje dhe heshtjeje, në Prishtinë kishte shkelur një shqiptar i madh, i kulturuar deri në palcë, erudit dhe i urtë, që të ngjallte respekt me të gjithë qenien e tij, aq më tepër me dijen e pafund. Më shumë se sa një njeri i zakonshëm, ai dukej si një profet dhe ishte i tillë. Aleks Buda, kryetari i parë i Akademisë së Shkencave, do të pritej në Kosovë si një hyjni. Zgjedhja kishte qenë e përsosur. Nga të gjitha anët e Kosovës njerëzit, sidomos të rinjtë, ecnin rrugë e pa rrugë, natën kur ishin klandestinë në vendin e tyre, për të dëgjuar profesorin namëmadh, e ndoshta, po i priu fati, për ta takuar. Aleks Buda do të jetë lajmësi më i gjetur i Shqipërisë, asnjë mesazh tjetër nuk do të kishte vlerë sa vetë ai.

Ndërkohë nga Prishtina do të vinin në Tiranë një grup gazetarësh të "Rilindjes", të zgjedhur me kujdes nga regjimi, emrat e të cilëve nuk thoshin asgjë, pasi nuk lexoheshin. Dhe, si ndodh shpeshherë me të panjohurit, askush nuk do ta kishte marrë vesh ardhjen e tyre, nëse në një cep të gazetës "Bashkimi" nuk do të ishte vënë një shënim i vogël. Vetëm kaq.

Nga ana tjetër, në universitetin e Prishtinës ishin mysafirë dhe jepnin leksionet e tyre korifejtë e mendimit shkencor shqiptar, ëndërrimi i plejadave shqiptare në Kosovë, si Eqrem Çabej, Aleks Buda, Shaban Demiraj, Androkli Kostollari, Kristo Frashëri, dhe Rexhep Mejdani, dijetarët më të shquar të shkencave albanologjike e historike. Ribotohej Kadare dhe Agolli si dhe "Veprat e Plota" të Poradecit.

Në vitin 1972, në muajin tetor, Kadare shkel për herë të parë Fushë-Kosovën, e njohur nga serbët si Fusha e Mëllenjave, për të cilën kishte dëgjuar aq shumë. Fusha shtrihej e qetë, e rrokshme nga syri deri ku lejonte mjegulla që kishte rënë

bri saj. E ftohtë, si në çdo prag dimri. Monumenti i Betejës së Kosovës, ndodhur në vitin e largët 1389, që duhej të ishte shenjë e ndjenjës së përbashkët, në fakt është kthyer në të kundërt, në minierë të urrejtjes dhe të kriminit. Sapo janë botuar, nën kujdesin e poetit të shquar, Azem Shkreli, korpusi i plotë i veprave të Kadaresë, në 10 vëllime. Në Tiranë, ku ende ka xhelozitë dhe pikëpyetje rreth devotshmërisë së shkrimtarit, ka ende hezitim dhe kjo nuk është bërë. Nuk do të bëhet asnjëherë. Kadare, i cili e njeh fort mirë klimën e tmerit, ka menduar se në Kosovë ka më shumë liri. Ia thotë këtë mikut të tij.

- Për të tjerët, për popujt sllavë, po, por për ne shqiptarët, jo, - i përgjigjet poeti i shquar, kur janë vetëm në makinë dhe ku mendohet se nuk do të përgjohen. Pastaj shton, - Ne jemi të huaj këtu, më keq se të huaj. Në sofrën e tyre sllave, ne jemi të tepërt.

Shqipëria kap çdo rast për të dëshmuar se vatra e nacionalizmit është aty.

Në vitin 1978, me një vëmendje tejet të veçantë u

përkujtua 100-vjetori i ngjarjeve të Prizrenit dhe për herë të parë, publikisht, ajo u quajt "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", duke i shtuar kështu, cilësimin "Shqiptare", si shenjë e etnisë kombëtare. Deri atëherë, ajo ishte quajtur thjeshtë "Lidhja e Prizrenit".

Të gjitha këto po sillnin imazhin e ri të lidhjeve të përbashkëta dhe, krejt befas, sidomos për njerëzit e zakonshëm, erdhi njoftimi se në Kosovë kishte ndodhur diçka.

E vërteta është se njoftimi i parë për demonstratat e 11 marsit në Kosovë është bërë i njohur, pra publik, më 17 mars 1981, gjashtë ditë pas zhvillimit të tyre. Ky ishte një njoftim i shkurtër, pa koment, burim i së cilës ishte agjencia e lajmeve Tanjug, dhe i cili u përforcua edhe nga disa agjenci të tjera informative. Nuk është bërë ndonjë kujdes i veçantë për afshimin e tyre dhe po ashtu, vëmendja ndaj botimit të artikullit apo dhënies së lajmit, nuk ka qenë e një rëndësie të veçantë. Në ditarin radioteleviziv të RTSH ai u dha, pa foto të veçanta, së bashku me lajmet e tjera të

korës së dytë, ndërsa në gazetën "Zëri i Popullit", që ishte asokohe gazeta kryesore e vendit, me më shumë se 100 000 kopje në ditë, shënim i vendos në faqen e katërt, majtas, aty ku edhe më parë vendoseshin lajmet e përgjithshme të politikës së jashtme.

Si do ta përcaktonte saktësisht analisti i shquar shqiptar Shaban Sinani, "kjo ishte faza e një mpirje të dukshme të opinionit në Shqipëri që, siç duket nga shënimet e vëzhguesve politikë, në Kosovë u shoqërua me ankth e padurim".

Ishin disa ditë, gjatë të cilave, njerëzit e thjeshtë dhe intelektualët ishin në pritje të një zhvillimi të ri apo edhe të ndonjë lajmi më të gjerë se kaq. Kishte një vajtje ardhje më të dendur tek njeri tjetri, sidomos tek të afërmit antenat satelitore e të cilëve mund të shfaqnin pamjet e Radiotelevizionit të Prishtinës. Mirëpo edhe aty, pas 11 marsit e deri më 26 mars, nuk mund të merrje më shumë se sa një informacion të cunguar e shenjat e dënimit të udhëheqjeve të larta politike,





republikane e krahinore. Por këto nuk i jepnin përmasat e asaj që kishte ndodhur. Për fat të keq, një mik i imi shqiptar i Kosovës, Idriz Zeqiraj, me të cilin, në vitin e parë të studimeve universitare, kishim jetuar për shumë kohë në një dhomë konvikti, ishte i dënuar dhe, si do lexoja më pas, në një rën pikë të aktakuzës, kishte, si një lloj marrëzie të kohës, edhe miqësinë me mua. Idrizi ishte dënuar përmes tre dëshmitarëve të rremë, njëri nga të cilët ishte tepelenas, ndërsa dy të tjerët shqiptarë të Kosovës. Pra, nuk kisha burim të brendshëm, por, ashtu si ujërat, edhe fjalët rrjedhin. Kishte filluar të flitej se kishte ndodhur një demonstratë studentore, por se gjithçka mbështillej rreth togfjalëshit, "kushite më të mira jetese".

Edhe pas shumë vitesh, secili që, në një mënyrë ose në një tjetër, ka kaluar nëpër ngjarjet e asaj kohe, qoftë edhe si i jashtëm, si ishim ne në Shqipëri, nuk mund ta ketë ndjerë veten jashtë tyre. Disa gjëra mbeten në kujtesë, ashtu si dita e 8 prillit 1981, kur, për herë të parë, në gazetën kryesore të kohës dhe, më pas, disa herë radhazi në emisione të veçantë radiotelevizive, u

shfaq qëndrimi i shtetit shqiptar. Ishte e diel dhe kisha shkuar në shtëpinë time në Shkodër. Ishte ditë plot diell, krejtësisht pranverë. Nga të gjitha radiot e komshinje dëgjoja spikerin e radios tek lexonte, për të disatën herë, tekstin e plotë të artikullit të parë në "Zërin e Popullit". Atë ditë, gazeta kishte dalë me dyfishin e tirazhit të saj, pra në 200 000 kopje, dhe, që në mëngjesin e hershëm, nuk e gjeje dot askund. Ishte shitur brenda pak çasteve dhe, nëpër të gjitha anët e rrugëve, ishin ndaluar njerëzit që kishin filluar ta lexonin, pa prituri që të shkonin në shtëpi.

Jam krejt i bindur se qëndrimin e shtetit shqiptar e përkrahën të gjithë shqiptarët, edhe ata që ishin pro regjimit, edhe ata që nuk e donin atë. Unë jam rritur në një familje e cila, në dy degët e mëdha të saj, kishte dy qëndrime të ndryshme. Shtëpia në të cilën jetoja unë, e njohur si "Shtëpia e madhe e Gjylbegajve", kishte qenë që në fillim në radhët e lëvizjes nacionalçlirimtare dhe kishte dhënë tre dëshmorë. Njëri prej tyre ishte vëllai i nënës, Naim Gjylbegu, i cili u vra në Vig të Mirditës, jo nga gjermanët, por nga ballistët e Markagjonit.

Shtëpia tjetër, jo larg nesh, që njihej si "Gjylbegët tek Çinari Hoxhë Dheut" kishte qëndruar në anën e kundërt. Madje njëri prej banorëve të saj, Musa Gjylbegu, u bë edhe ministër në një qeveri kolaboracioniste, në vitin 1944. Sidoqoftë, të dy shtëpitë, por edhe të tjerat e të njëjtit fis aty rreth e rrotull, kishin qenë gjithnjë të afërta për njëra tjetrën. E solla shembullin, ndoshta gjatë, për të treguar se të dy shtëpitë e mbështetën njëllor qëndrimin e shtetit shqiptar dhe unë këtë, duke qenë "i brendshëm", e di fare mirë. Mund të shkoj edhe më tej: djemtë e dy shtëpive ishin të gatshëm, në rast se organizohej diçka, edhe të luftonin për Kosovën, pavarësisht se nën urdhrat e kujt do të ishin. Befas, në të gjitha shtëpitë e Gjylbegajve, filluan të tregoheshin fotografi të kohës kur "Kosova kishte qenë Shqipëri", pra të viteve të luftës, kur ishte bërë bashkimi. Foto në të cilat ose dalloheshin pjesëtarë të fisit të veshur ushtarakë, si në fakt kishin qenë, ose me qelesht e bardha në kokë dhe kostume evropiane të modës së fundit, nga universitetet që kishin ardhur. Ata, që dikur quheshin

ballistë, kishin një ndjenjë më të shprehur përafrimi, ndoshta ngaqë mendonin se kishin pasur të drejtë në kohën e tyre.

Nuk do të flas për reagimet në shtypin apo median e kohës. Për shumë prej tyre mund të besohet se gjithçka ishte e përlogaritur. Për një shtet të centralizuar si Shqipëria, kjo ishte e besueshme. Asnjë lloj fushate propogandistike, edhe ajo më e zakonshme, të themi, mbjelljet e vjeshtës, nuk i lihej rastësisë, e jo më t'i lihej rastësisë, një ngjarje e tillë madhore. Mirëpo, sado të ishte e përlogaritur, ndjehej në deklarimin e të gjithëve se tashmë ishte gjithçka ndryshe, se çdo gjë po kishte një fillësë krejt tjetër dhe një qëndrim, po ashtu, krejt më të natyrshëm. Njerëzit ishin në pritje se çfarë do të ndodhte në të nesërmen, cili lajm i ri do të vinte, dhe kjo nuk ishte thjeshtë shenjë kurioziteti apo e dëshirës për të mbushur hapësirën informative. Ishte shumë më tepër.

Mbaj mend një rast, i cili, megjithëse është krejt i thjeshtë, përsëri dëshmon për shumëçka. Ishim në shtëpinë e mikut të tim eti, Qamil Çelës, një figurë e njohur politike e viteve '30 dhe më pas, mik i

afërt i Fan Nolit, Sejfulla Malishovës, Gjergj Fishtës, Petro Markos, Zoi Fundos dhe Ali Kelmendit. Nuk ishte përkrahës i Enverit, megjithëse e kishte njohur atë që në rininë e hershme. Ish kryetari i Kryqit të Kuq Shqiptar e atdhetar i madh, Qamil Çela kishte shumë vite që ishte tërhequr në shtëpizën e tij të vogël, diku në qendër të qytetit të Elbasanit të vjetër. Po jepeshin lajmet e orës 20:00 dhe, tashmë nuk e di nëse rastësisht apo se qëllimisht ashtu ishte vendosur, spikeri befasisht tha: "Vazhdojmë me lajmet e brendshme. Sot ne Prishtinë..." dhe vijoi me lajmin.

Njeriu i moshuar lëvizsi befasisht nga vendi dhe tha me një zë të gjallëruar: "Oh sa mirë, sa mirë! Lajmi nga Prishtina është një lajm i brendshëm".

Njerëzit ishin aq të përqendruar, sa i vërenin e, njëkohësisht, gëzoheshin nga të tilla detaje. Qamil Çela kishte qenë mik i afërt i Bedri Pejës. Ai ndiqte gjithçka që shkruhej në shtypin e kohës dhe në një hartë të madhe të Kosovës shënonte lëvizjet më të rëndësishme, me shkrimin e tij të vogël e të rrumbullakët. (Vijon)



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**

Jupa: Synojmë kualifikimin historik

Hendbollisti Kastriot Jupa për "Epokën e re" ka bërë me dije se Kosova synon suksesin historik me kualifikim në Kampionatin Evropian. "Ndeshja e ardhshme me Malin e Zi do të jetë një finale për ne për shkak që me një fitore eventuale i hapim dyert tona për një kualifikim historik në evropian dhe kemi gjasa shumë të mëdha ta arrijmë këtë sukses", ka deklaruar Jupa



Për fitoren e Kosovës ndaj rumunëve ka shkruar edhe uebfaqja e Federatës Evropiane e Hendbollit. "Kosova s'ka fituar asnjëherë një ndeshje garuese jashtë vendit, mirëpo ajo shokoi Rumaninë me një sulm verbues dhe një mbrojtje të fuqishme, duke fituar 30:25. Pas

një fillimi të fuqishëm kundër Malit të Zi, Rumania u shemb tërësisht këtë javë, duke humbur tri pikë kundër Kosovës, pas barazimit 23:23 javë më parë", thuhet në njoftimin e Federatës së Hendbollit të Kosovës. Në fund hendbollisti Jupa foli edhe për

synimet që ka me skuadrën e Besa Famgas në hendbollin e Kosovës për edicionin 2020/2021. "Me Besën synimet janë si çdo vit që ta përfundojmë sezonin pa asnjë humbje dhe me dy trofetë në Pejë", ka deklaruar Jupa.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 MARS - Hendbollisti Kastriot Jupa një ditë pas fitores së madhe kundër Rumanisë me rezultat 30-25 në kualifikimet evropiane, ka thënë se kjo ndeshje ishte përgatitje mirë dhe paraqitja ishte më e mira në vitet e fundit. "Ndeshjen e kishim përgatitur aq mirë saqë asnjëherë nuk na është rrezikuar fitorja. Ishte ndër ndeshjet më të mira që kemi zhvilluar tërë këto vite dhe ky është ende fillimi i një grupi të artë. Me këtë fitore kemi rritur gjasat për t'u kualifikuar që u

prish punë ekipeve të tjera që pretendojnë për kualifikim në Evropian", ka thënë Jupa për "Epoka e re". Ndeshjen e radhës "dardanët" në hendboll e kanë kundër Malit të Zi, kurse hendbollisti i spikatur Kastriot Jupa e ka quajtur këtë ndeshje si një finale dhe është optimist për sukses. "Ndeshja e ardhshme me Malin e Zi do të jetë një finale për neve për shkak që me një fitore eventuale i hapim dyert tona për një kualifikim historik në evropian dhe kemi gjasa shumë të mëdha ta arrijmë këtë sukses", ka deklaruar Jupa.

Reali synon kualifikimin në çerekfinale



MADRID, 15 MARS (ER) - Real Madridi do të kërkojë të sigurojë një vend në çerekfinalet e Ligës së Kampionëve kur do të përballet sonte (e martë) me Atalantën në ndeshjen kthyesë. Reali kërkon ta shmangë eliminimin për herë të tretë radhazi pasi në dy edicionet e kaluara ishte eliminuar nga Ajaxi dhe Manchester City. "Kundër Atalantës nuk mund të jesh në asnjë çast i qetë, edhe pse fituam takimin e parë. Ajo është tërbuar për kartonin e kuq që mori në ndeshjen e parë dhe ka të drejtë. Do të luajë futbollin e tyre, do të sulmojë, madje do të

TË MARTËN TAKOHEN:

21:00 Real Madrid - Atalanta	(1-0)
21:00 Man.City - Moenchengladbach	(2-0)

japë edhe diçka më shumë", ka thënë Zinedine Zidane, trajner i Real Madridit. "Los Blancos" ka një avantazh të lehtë nga ndeshja e parë, pasi e mposhti Atalantën me rezultat 0-1. Realit i munguan disa lojtarë në ndeshjen e parë dhe Isco luajti në qendër në mungesë të Karim Benzmas, por edhe përkundër kësaj, arriti të marrë fitore falë golit të shënuar nga Mendy, katër minuta pa përfunduar ndeshja. Skuadra që drejtohet nga Zinedine Zidane në këtë ndeshje vjen pas fitores në fundjavë kundër Elches (2-1). Në anën tjetër, Atalanta të premtën e mposhti 3-1 Spezian dhe kishte më shumë kohë që të përgatitet për përballjen kundër Realit.

Skuadra italiane edicionin e kaluar në çerekfinale ishte eliminuar nga skuadra finaliste, PSG dhe tash synon që ta eliminojë Realin edhe pse një gjë e tillë nuk do të jetë aspak e thjeshtë. Skuadra e Realit do të jetë pa Dani Carvajal, Alvaro Odriozola, Marcelo, Mariano Diaz dhe Casemiro. Në anën tjetër Atalanta do të ketë mungesën e Hans Hateboer dhe Freulerit. Ndryshe nga Reali, Manchester City pritet ta ketë më të lehtë kalimin në çerekfinale për faktin se në Gjermani e mposhti Borussia Moenchengladbachun me rezultat 0-2. Pavarësisht se klubi gjerman di të jetë i paparashikueshëm, City është favorit për t'u kualifikuar tutje.

Përzgjedhësi Nees publikon listën e 'dardanëve' të rinj

Prishtinë, 15 mars - Përzgjedhësi i Përfaqësueses U21 i Kosovës në futboll, Michael Nees, e ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për dy ndeshjet miqësore të këtij muaji kundër Katarit në Doha. Në listën e përzgjedhësit Nees janë përfshirë 25 futbollistë, derisa këto dy takime do t'i shërbejnë atij për ta pasur një pasqyrë sa më reale të ekipit, por edhe për t'u përgatitur sa më mirë për ndeshjen e parë të fushatës

kualifikuese për Evropianin 2023 kundër Andorrës, që do të luhet më 8 qershor në Prishtinë. Miqësoret me Katarin zhvillohen në sajë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kohë më parë e kanë nënshkruar krerët e të dy federatave. Ndeshja e parë zhvillohet më 26 mars, kurse ndeshja e dytë më 29 mars. Ekspedita e Përfaqësueses U21 do të udhëtojë në Doha mbrëmjen e 21 marsit.

LISTA E FUTBOLLISTËVE

DAVID NRECA BISINGER, AGRON KOLAJ, LEO BESSON, FLORIAN HOXHA, LEART SADIU, EDVIN KURTULUS, VALON ZUMBERI, LEONAT VITIJA, ALBION PLLANA, BUJAR PLLANA, SIMON LOSHI, MELOS BAJRAMI, ARLIND SHABANI, ALTIN KRYEZIU, ENDRIT MORINA, QENDRIM ZYBA, ADRIAN PAJAZITI, RILIND HETEMI, VALMIR VELIU, ALTIN ZEQRIRI, DION BERISHA, RILIND NIVOKAZI, ARIAN KASTRATI, VETON TUSHA, MARK MARLEKU.



Clippersat pësojnë humbje nga New Orleansi

NEW ORLEANS, 15 MARS - Los Angeles Clippers ka vazhduar formën e luhatshme në NBA. Pasi triumfoi ditë më parë ndaj Warriorsit, Clippersat kanë pësuar humbje tani në udhëtim te New Orleans Pelicansi me 20

pikë diferencë, 135-115. Ka qenë një ndeshje e dominuar nga vendësit, të cilët që nga çereku i parë krijuan epërsi të cilën nuk e lëshuan nga dora gjatë gjithë ndeshjes. Zion Williamson ishte më efikas në

këtë takim për vendësit me 27 pikë, dy kërcime e pesë asistime. Me lojë të mirë u dallua edhe Brandon Ingram që shtoi 23 pikë e pesë asistime, derisa Lonzo Ball kontribuoi me 17 pikë. Kawhi Leonard

ishte më efikas te mysafirët me 23 pikë, por që nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen. Rezultatet: Orlando M.-Miami H. (97-102), Atlanta H.-Cleveland C. (100-82), Houston R.-Boston C. (107-134),



Reja: Kundër Anglisë luajmë për tri pikë

TIRANË, 15 NËNTOR - Ndeshjet e Kombëtares së Shqipërisë po afrohen dhe atmosfera ka filluar të ndihet gjithmonë e më shumë. Trajneri i Kombëtares kuqezi, Edi Reja, ishte në një lidhje direkte në emisionin "Zona Gol" me gazetarin Glend Tafaj, ku foli për punën e bërë gjatë këtyre muajve, për prurjet e reja për ndeshjet e radhës, por edhe pritshmëritë nga skuadra.

Si e shihni garën për titullin kampion në Itali?

Reja: Mendoj se gjërat po shkojnë si duhet për Interin, që është shkëputur dhe duket se do t'ia dalë me sukses. Është aty edhe Juventus, por zikaltrit duken më në formë, më me besim në aftësitë e tyre dhe po bëjnë mjaft mirë nga java në javë, ndaj janë në rrugën e duhur për titullin.

Është folur për një rikthim tuajin te Napoli, për të zëvendësuar Gattuson... A pati një negociatë të vërtetë dhe si trodhën ngjarjet?

Reja: Unë kam një marrëdhënie të shkëlqyer me presidentin De Laurentiis dhe ai më telefonon sa herë që është në vështirësi për ndonjë këshillë, megjithatë e kam thënë edhe më herët, që e kam mbyllur karrierën me klube. Ka shumë stres puna në një klub dhe nuk mund të përballoj një ngarkesë të tillë. Edhe te Shqipëria ka stres, por këtu aktivitetet janë pak më të rralla dhe ngarkesa më e ulët.

Hysaj dhe Strakosha, dy lojtarë që janë pjesë e ish-skuadrave të tuaja... A jeni i kënaqur me situatën që po kalojnë?

Reja: Hysaj ka luajtur shumë dhe ka bërë mirë. Kur ka kalendar të ngjeshur, të vjen radha gjithmonë për të luajtur dhe ai ka treguar se mund ta bëjë shumë mirë si në krahun e djathtë, ashtu edhe në të majtë. Ndryshe nga viti i kaluar me Ancelottin, Gattuso e ka aktivizuar shumë shpesh dhe sonte ai bëri një tjetër ndeshje shumë të mirë. Mbyllte vazhdimisht krahun e tij dhe ndihmoi jo pak edhe në fazën e avancuar, teksa ishte një nga nismëtarët e aksionit të golit. Strakosha ka një dëmtim në gju, që nuk po e lë të stërvitet si duhet, por ka cilësi shumë të mira teknike dhe është shumë i zoti, ndaj shpresoj që të rikthehet sa më shpejt të luajë për Lazio dhe Kombëtaren.



Si kanë qenë këta muaj pa futboll, pasi kombëtarja nuk grumbullohet që prej nëntorit?

Reja: Kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me lojtarët dhe kemi komunikuar shpesh, sidomos me ata që flasin italisht. Kemi vëzhguar ecurinë e tyre dhe të gjithë mezi presim të grumbullohemi e të bëjmë mirë me kombëtaren.

A ju druheni dëmtimeve, pasi Abrashi është në dyshim, Gjasula sapo është rikthyer dhe Broja la fushën mes dhimbjeve?

Reja: Për fat të keq, dëmtimet na kanë hapur punë shpesh, pasi edhe këtë herë Abrashi ka problem. Ai është një lojtar shumë i rëndësishëm për ne dhe ka bërë mirë sa herë që ka luajtur, por nuk luan prej kohësh për shkak të një dëmtimi. Gjasula është rikthyer të stërvitet me skuadrën dhe më ka garantuar që ndihet mirë, ndaj do ta thërrasë për të parë nëse mund të luajë nga fillimi apo jo. Kemi shumë nevojë për të, pasi në mungesë të Abrashit, nuk kemi lojtarë tjetër me ato tipare para mbrojtjes.

A do të ketë prurje të reja në kombëtare?

Reja: Një prej tyre do të jetë Florian Kamberi, që është grumbulluar edhe herë të tjera, por nuk ka pasur mundësinë të luajë. Tani ai po bën shumë mirë në klubin e tij dhe kemi vendosur ta thërrasim për ndeshjet e radhës. Një emër tjetër që ka bërë shumë mirë këtë sezon, është edhe Nedim Bajrami i Empolit. Kam folur shpesh me të dhe kam bërë punë bindëse që ta zgjedhë Shqipërinë. Ai tashmë ka dhënë miratimin për ta veshur fanellën kuqezi dhe është në pritje të pasaportës. Shpresoj ta marrë që ta kemi për këto tri ndeshje, pasi ka shumë pjekuri, pavarësisht prej moshës shumë së re.

Cili është objektivi i Shqipërisë për këto tri ndeshje?

Reja: Detyra jonë është që të bëjmë mirë dhe ta marrim maksimumin ndaj Andorrës dhe San Marinos. Me gjithë respektin, këta janë kundërshtarë më poshtë nesh dhe duhet ta marrim maksimumin. Sa i përket ndeshjes me Anglinë, edhe aty do të luajmë për tri pikë, por është një sfidë e vështirë. Megjithatë, unë nuk do të firmosja për barazim, pasi ndeshja si fillim duhet luajtur dhe ne jemi gati të bëjmë maksimumin ndaj tyre.

Federata ka kërkuar që të lejohen 30% e tifozëve ndaj Anglisë. Do t'ju pëlqente një vendim i tillë?

Reja: Do të ishte e mrekullueshme të kishim 30% të tifozëve në stadium, pasi do të ishin një ndihmë e madhe, sidomos për ndeshjen me Anglinë. Pa tifozë ndeshjet nuk kanë të njëjtin entuziazëm dhe të njëjtën bukuri, ndaj do të donim t'i kishim si një shtysë më shumë.

Ndërkohë që prisni radhën për vaksinim në Itali, mund ta bëni vaksinën edhe në "Air Albania", ku ka nisur ky proces tashmë...

Reja: Do të pranoja ta bëja menjëherë, pasi kështu do të ndihesa më i sigurt e më i mbrojtur. Në Itali më vjen radha në muajin maj, ndaj nuk do të ishte keq ta bëja më herët.

Deri ku mund të shkojë Shqipëria në këtë edicion?

Reja: Është një grup i vështirë, pasi vetëm Andorra dhe San Marino janë më të dobëta se ne. Hungaria po kalon një moment shumë të mirë, ashtu si Polonia e Anglia, që kanë vlera shumë të mëdha. Megjithatë ndeshjet luhen në fushë dhe unë mezi pres të shoh a kemi bërë hapa të tjerë përpara në rrugëtimin tonë.

SHKURT

Mërgim Berisha ftohet nga Gjermania U21

Mërgim Berisha është ftuar nga Përfaqësuesja U21 e Gjermanisë për Kampionatin Evropian. Lajmi është bërë me dije nga federata gjermane në rrjetet sociale. Ylli nga Kosova ka shkëlqyer këtë edicion me RB Salzburgun në Austri. Ai është ftuar nga Gjermania U21 për të luajtur në Kampionatin Evropian që zhvillohen ndeshjet e grupeve në mars. Berisha këtë sezon në të gjitha garat me Red Bull Salzburgun ka shënuar 16 gola dhe ka bërë 10 asistime. Megjithatë, në këtë listë nuk janë përfshirë sulmuesi Leon Dajaku dhe mesfushori Meritan Shabani.

Ronaldo thyen rekordin e Peles, i premtun besnikëri Juventusit

Me tregolëshin kundër Cagliari, Cristiano Ronaldo theu rekordin e Peles, atë me 767 gola në karrierë ku përfshiheshin edhe finalizimet me San Paulo State, skuadra ushtarake braziliane. CR7 vendos një rekord të ri, në kuotën e 770 golave, duke u shndërruar në golashënuesin më të mirë në histori. Me një status të gjatë në profilin e tij në "Instagram", ylli portugez ngre në qiell figurën e Peles, ndërsa nuk harron t'i falënderojë të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë rekord unik. Për herë të parë pas eliminimit nga Porto në Ligën e Kampionëve, Ronaldo ka thyer heshtjen duke i premtuar besnikëri Juves: "E ardhmja është nesër dhe ka ende shumë për të fituar me Juventusin dhe Portugalinë". Edhe drejtori sportiv i "Zonjës së Vjetër", Fabio Paratici, theksoi se Ronaldo përfaqëson të tashmen dhe të ardhmen e Juves.

Mane: Do të bëjmë gjithçka për ta fituar Ligën e Kampionëve

Liverpooli po kalon momentin më të keq në vitet e fundit. "The Reds" po vuan në kampionat, aty ku renditet në vend të tetë. Askush nuk e kishte menduar që skuadra që dominoi në futbollin anglez sezonin e kaluar, sivjet vuan për t'u renditur në katërshen e parë. Sadio Mane e pranon situatën e vështirë në prononcimin e dhënë për "Goal". Liverpooli është kualifikuar në çerekfinalet e Ligës së Kampionëve dhe do ta bëjë maksimumin për të sjellë trofeun e madh për herë të shtatë në "Anfield". "Fitimi i këtij turneu është objektivi kryesor. Nuk do ta kemi të thjeshtë, pasi do të përballemi me skuadrat më të mira të Evropës, por jemi gati t'i mposhtim. Do të bëjmë gjithçka për ta fituar Ligën e Kampionëve", ka thënë Mane.

Eriksen: Asnjëherë nuk kam kërkuar që të largohem nga Interi

Christian Eriksen është kthyer në një lojtar kyç për Interin e Antonio Contes, duke fituar një vend titullari dhe duke ulur në stol kilianin, Arturo Vidal. Danezi 29-vjeçar luftoi për ta bindur trajnerin Antonio Conte për cilësitë e tij, dhe kur të gjithë menduan se ai do të largohej nga Interi në merkaton e dimrit, erdhi dhe pika e kthesës, goli me goditje dënimi kundër Milanit në 1/8 e kupës së Italisë. "Ishte sezoni më i vështirë dhe më i kërkuar në karrierën time. Ishte sikur të ngjitesha lart e poshtë vazhdimisht, por tani ndihem sikur jam ambientuar mirë. Me të vërtetë dëshiroja të luftoja për vendin tim dhe gjithmonë e kam bërë. Isha i sigurt se nëse do të vinte shansi im, do të bëja më të mirën time. Ishte e vështirë mendërisht. Kam ardhur në Inter për të luajtur futboll dhe kur nuk ju lejohet ta bëni, është e bezdisshme", ka thënë Eriksen.

Sevilla hyn në garë për Thauvin

Florian Thauvin është një nga lojtarët më të vlefshëm në Evropë që do të jetë okazon në verën e ardhshme, pa skuadër dhe pa shpenzime të mëdha. Prej kohësh, sulmuesi i Marseilles ka deklaruar se rinovimi është larg çka ka ndezur një luftë të madhe për shërbimet e tij. Sevilla është ekipi më i interesuar për 28-vjeçarin teksa edhe Milani ndjek me vëmendje situatën, por tani është përfshirë në garë edhe Leicesteri. Me këta të fundit që pothuajse e kanë të sigurt një vend në Ligën e Kampionëve, nuk do ta kenë të vështirë t'i ofrojnë një pagë të rëndësishme sulmuesit francez.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë - Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. - Prishtinë, me datë 12.03.2021, **SHPALLE:**

KONKURSI PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: punëtor fizik – pastrues/e të mirëmbajtjes higjienike në njësinë e ndërtimtarisë dhe mirëmbajtjes higjienike në Departamentin tekniko - higjienik (4 punëtorë/e);

II. Numri i referencës: NPL -D.T. 12/03/21/1;

III. Detyrat dhe përgjegjësitë:

Organizon, mbikëqyr dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e punëve dhe detyrave të punës dhe sidomos këtyre punëve:
- kryen të gjitha punët fizike në nivel të, NPL "PALLATI I RINISË" SH.A. në Prishtinë
- bënë bartjen e panove për programe të ndryshme në qendër dhe në qytet,
- sjelljen dhe largimin e sendeve të ndryshme dhe të inventarit nga lokalet e NPL "PALLATI I RINISË" SH.A. në Prishtinë,
- bartjen, montimin dhe demontimin e ringut, tribunave, skelave të ndryshme hedhjen e mbeturinave,
- pastrimin dhe mirëmbajtjen e lokaleve dhe hapësirave në objekt, lokalet e punës në qendër dhe në të gjitha sipërfaqet tjera, pastrimin e mureve, karrigeve, tavolinave dhe enterierit tjetër,
- mirëmban pastërtinë e dyshemesë, tepihëve, larjen e dritareve, perdeve e tjera,
- bënë pastrimin me mjete teknike të gjitha sipërfaqeve që mund të pastrohen në qendër e edhe me makinë thithëse, dhe u ndihmon punëtorëve tjerë në Departamentin e vet dhe në Departamente tjera lidhur me pastërtinë,
- kryen edhe punë tjera me urdhëresën e para punëtorit, kryepunëtorit dhe udhëheqësit të njësisë – përgjegjësit të ndërtimtarisë dhe dhe mirëmbajtjes higjienike.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni);
- Letër motivuese;
- Dëshmi për shkollimin e noterizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës nga (punëdhënësit, nga Trusti Pensional dhe nga ATK-ja);
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera.
- Certifikata e mjekut,
- Certifikata se keni zotësi të veprimit,
- Kopja e letërnjoftimit;
- Adresa e vendbanimit;
- Nr. i telefonit kontaktues si dhe
- E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

- Diploma e noterizuar e kualifikimit fillor,
- Një (1) vjet përvojë pune në vendin e punës,
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

VI. Kohëzgjatja e emërimit:

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data e publikimit.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:

- Aplikacionet për punësim mund të merren fizikisht në zyrën e Departamentit të Administrimit Qendror dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë si dhe mund të shkarkohet në web-faqën zyrtare/www.pallatirinise.com si dhe në facebook-un zyrtar/Pallati i Rinisë, duke klikuar paraprakisht/like.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Edison Kasolli shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX shfmu " Vëllezërit Frashëri " Planej.
- ▶ Gezim Qilingeri shpall të pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Vendim Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.
- ▶ Ramadan Kabashi shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Arif Elshani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.
- ▶ Nasip Jemini shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Blendin Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.
- ▶ "Matoshi 99 O.P." shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70676656. Nr. UNIK 811195529, nr. fisk. 600499108.
- ▶ "Rembek" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330349888.
- ▶ Auto Shkolla "Baza-L" vazhdon ofertën me 50% zbritje deri më 20.03.2021. Gjilan.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

